



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.T.Sh. "A-Mol Studio"
Numri i biznesit - 70546434
Pronar – Rrahman FETAHU
OSHMA A- MOL TV
Prishtinë

Ref:1904/529/LIC/ni

VENDIM

*për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim
përmes operatorëve të shpërndarjes A- MOL TV, me seli në Prishtinë*

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. A- MOL TV është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 17 mars 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA A- MOL TV.
3. Me datën 17 mars 2019, ka skaduar afati i licencës së A- MOL TV, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 28 dhjetor 2018, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, e ka njoftuar, përmes e-mali, Ofruesin e Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes Klan Kosava, lidhur me skadimin e licencës në vitin 2019, si dhe me afatet dhe obligimet që parashihen me nenin 25 të Ligjit për KPM, për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

5. Më 28 dhjetor 2018, A- MOL TV ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

Arsyetimi

6. OSHMA A- MOL TV, ka shfrytëzuar mundësin që i ofron Neni 25 i Ligjit të KPM-së dhe ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së, në pajtim me procedurat e përcaktuara administrative nga KPM.
7. Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson:

“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkëljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

VENDIM

8. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur me datën 26 prill 2019, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së A- MOL TV, për të ushtruar veprimtarin si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale, me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
9. Licenca e KPM-së për OSHMA A- MOL TV do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 17 mars 2019.
10. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, të OSHMA A- MOL TV, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



06.05.2019
datë